Nr.	Kulturat	Sipërfaqja (ha)	Dëmtimi në euro
1.	Vreshta	19.26	26,092.00 euro
2.	Grurë	6.69	5.352.00 euro
3.	Perime	25.30	381.989.00 euro

RAPORTI I MBJELLJEVE DHE KORRJE-SHIRJEVE 2019

MBJELLJET PRANVERORE 2019

Gjatë realizimit të mbjelljeve pranverore 2019 nuk është paraqitur ndonjë pengesë për realizimin e mbjelljeve vjeshtore ka pasur në sasi të mjaftueshme të farërave, plehut mineral e tjera. Gjatë fushatës së mbjelljeve, moti nuk ka qenë i përshtatshëm për arsye të të reshurave dhe ka prolonguar për disa ditë realizimin e mbjelljeve.

Në pranverë janë mbjellur këto kultura bujqësore:

Nr	Kulturat	Planifikimi (ha)	Realizimi	Pëqindja
1	MISËR	4.300 ha	4300 ha	100
2	ELB	100 ha	100 ha	100
3	TËRSHËRË	120 ha	120 ha	100

4	BIMË FURAGJERE	160 ha	160 ha	100
5	PATATE	110 ha	110 ha	100
6	FASULE MONOKULTURË	12 ha	12ha	100
7	PERIME	980 ha	980 ha	100
8	Kulturat tjera	10 ha	10 ha	100
	Gjithsejtë	5.792ha	4.792 ha	100

FUSHATA E KORRJE SHIRJEVE

DBPZHR ka bërë regjistrimin e autokombajnave dhe është bërë takimi me kombajnerët ku janë njoftuar lidhur me rëndësinë e fushatës. Për fushatën e korrjshirjeve janë angazhuar 62 autokombajna. Rendimenti këtë vit ka qenë mes 3000- 3500 kg /ha

Nr.	Kultura	Sipërfaqet e planifikuara për korrje	Realizimi	Përqindja
1	Gruri	4500 ha	4500 ha	100 %
2	Thekna	140 ha	140 ha	100 %
3	Trokal	20 ha	20 ha	100 %
	Total	4.660 ha	4.660 ha	100 %

MBJELLJET VJESHTORE

Me poshtë paraqesim realizimin e mbjelljeve vjeshtore sipas kulturave dhe raportet nga fermerët:

Nr.	KULTURAT	PLANI ha	REALIZIMI ha	%
1.	G R U R I	4.500 ha	4500 ha	100 %
2	THEKNA	140 ha	140 ha	100 %
3.	TROKAL	20 ha	20 ha	100 %
	TOTALI	4.660 ha	4660 ha	100 %

Sipërfaqja e Pyjeve dhe tokave pyjore në menagjimin e APK-së Gjakovë në Sektorin Shtetëror janë 16800ha të ndara në katër (4) njësi menagjuese: 1. Dushkaja, 2. Pashtrik-II, 3. Qerreti dhe 4. Maja. Pyjet në sektorin privat janë afërsisht 10000 ha. Në sektorin e pylltarisë janë të angazhuar 10 (dhjetë) roje pylli, një teknik si dhe përgjegjësi i sektorit.

Zjarret në pyje/ Gjatë muajit Mars, Prill, Shtator dhe Tetor në pyjet e sektorit shtetëror dhe privat, në bashkëpunim me Brigadën e Zjarrfikësve si dhe ndihmën e banorëve lokal është intervenuar në shuarjen e zjarreve dhe pasojat kanë qenë minimale.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit nga fushëveprimi i saj i përcaktuar, përveç aktiviteteve të rregullta në procedimin dhe zgjidhjen e kërkesave të ndryshme të parashtruara nga personat fizik dhe juridik, zhvillon dhe një mori aktiviteteve tjera nga spektri i urbanizmit dhe mbrojtjes së mjedisit dhe bashkëvepron dhe asiston në aktivitetet e Drejtorive tjera.

- Për periudhën Janar – Nëntor, gjithësejt kemi 1109 kërkesa - lëndëve të parashtruara pranë DUMM-së gjatë kësaj periudhe dhe atyre të përcjellura nga vitit paraprak;
- Për periudhën Janar – Nëntor, gjithësejt kemi 104 Leje Ndërtimore të lëshuara apo Kërkesa të aprovuara.
- Puna në vazhdimësi në përzgjedhjen dhe vlerësimin e ofertave për PUNIMIN E HARTËS ZONALE.

Burimet e te Ardhurave	Planifikimi - vjetor 2019	Planifikimi Janar - Nëntor 2019	Realizimi Janar - Nëntor 2019	Perq.e realiz. Janar- Nëntor 2019
Drejtoria e Urbanizmit	450,375.00	415,975.00	407,036.66	97.85
Lejet e ndertimit (Taksa administrative dhe Tarifa rregullative per rritjen e densitetit)	343,405.00	317,405.00	377,070.65	118.80
Taksa komunale:(Pelqimet endryshme ,ndarjet fizike, ekstraktet nga planet, lejet dhe pelqimet për objektet e infrastruktures dhe taksa nga leje mjedisore)	27,720.00	25,410.00	5,429.32	21.37
Kompenzimi për shfrytëzimin e hapsirës publike(Komisoni për objekte montuese-de montuese, për pano reklamuese dhe për hapsirat publike)	42,000.00	39,000.00	18,172.76	46.60
Qiraja : (Qiraja për shfrytëzimin e banesave nga programi i banimit social)	10,750.00	9,860.00		-
Propozim - taksat komunale nga trajtimi I ndërtimeve pa leje - legalizimi i objekteve	26,500.00	24,300.00	6,363.93	26.19

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik


Zyra për pagesën e taksës në firmë

Gjatë vitit 2019 ishte planifikuar që nga taksa në firmë të arrihen të hyra **42,000.00 €** ndërkaq, janë inkasuar **56,633.00 €** apo **130 %**. Në këtë rast kemi tejkalim të planifikimit për vitin 2019 me mbi 14,000.00 €, ndërsa këtë vit kemi një rënie krahasuar me vitin e kaluar për arsye se gjatë vitit 2019 me ligj janë ndaluar të funksionojnë bastoret sportive e që kanë pasur taksë në firmë dhe disa nga to kanë paguar. Ndërsa taksa për zgjatje të orarit të punës ishte planifikuar të jetë **12,000.00 €** ndërkaq janë realizuar **8,340.00 €** apo **69 %**, pra kemi një tejkalim të të hyrave sipas planifikimit për vitin 2019. Sa i përket taksës për zgjatje të orarit të punës kemi ngritje në krahasim me dy vitet e kaluara edhe për faktin se koordinimi mes DZHE-së dhe Drejtorisë për Punë Inspektuese ka qenë më i mirë dhe ka rezultuar me rritje të mbledhjes së kësaj takse.

2019

	Planifikimi (€)	Realizimi (€)	%
Taksa në firmë	42,000.00	56,633.00	134 %
Taksa për zgjatje të orarit të punës	12,000.00	8,340.00	69 %
Totali	54,000.00	64,977.00	120 %

Paraqitja tabelore e taksës në firmë



Qendra komunale e biznesit (QKB)

Decentralizimi i kompetencës për regjistrim të bizneseve nga niveli qendror në atë lokal është reflektuar pozitivisht tek afaristët sepse tash e tutje nuk kanë nevojë të humbin kohë dhe të bëjnë shpenzime për të shkuar në Prishtinë për tu regjistruar si biznese siç ka qenë deri në vitin 2010.

Gjatë vitit 2019 Qendra Komunale për Biznese në Komunën e Gjakovës ka ofruar këto shërbime dhe ka arritur këto rezultate:

- Regjistrimi i bizneseve te reja
- Shuarje të bizneseve
- Informata për bizneset
- Kërkesa për ndryshime të Certifikatave të bizneseve

Paraqitja tabelore e regjistrimit të bizneseve për vitet 2017 – 2019

2017			2018			2019		
Biznese Individuale B.I	244		Biznese Individuale B.I	239		Biznese Individuale B.I	210	
Biznese SH.P.K	63		Biznese SH.P.K	102		Biznese SH.P.K	219	
Total	307		Total	341		Total	429	



Paraqitja tabelore e aktiviteteve tjera të QKB për vitet 2017 - 2019

2017		2018		2019	
Mbyllje bizneseve	92	Mbyllje bizneseve	129	Mbyllje bizneseve	125
Ndryshime në biznes	216	Ndryshime në biznes	234	Ndryshime në biznes	1735
Kërkesa (Informata biznesi)	235	Kërkesa (Informata biznesi)	251	Kërkesa (Informata biznesi)	287

Gjatë vitit 2019 kemi filluar të bëjmë rifreskimin e të dhënave se sa biznese janë aktive (deklarojnë), dhe sipas të dhënave të dërguara pas kërkesës sonë në Agjencinë Tatimore të Kosovës në Gjakovë (ATK), aktive apo biznese që deklarojnë janë rreth **4000** biznese.

Poashtu gjatë këtij viti me Kërkesë të ARBK - së, është paraparë që të bëhet ndërrimi i certifikatave të biznesit, ku gjatë vitit 2019 janë ndërruar mbi 1700 certifikata të bizneseve. Ndërrimi i këtyre certifikatave ka qenë obligativ dhe është bërë pa pagesë.

Gjithashtu jemi duke zhvilluar një bazë të të dhënave të rifreskuara për numrin e bizneseve, veprimtarinë e tyre, nr. punëtorëve, adresën, nr. telefonit dhe të dhëna tjera të cilat janë të rëndësishme që të dimë sa biznese kemi në Komunën e Gjakovës dhe cilat janë fushat ku operojnë këto biznese.

Zyra e Turizmit

Gjatë vitit 2019 ne si Drejtori për Zhvillim Ekonomik kemi realizuar investime kapitale në disa projekte të cilat janë të lidhura me fushën e turizmit e cila zyre funksionon në kuadër të DZHE-së. Këto projekte do të ndikojnë në rritjen e vizitorëve në Komunën toneë cila shprehet në zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Këto projekte siç janë: Shpella Kusarit, Ura Terzive, Ura Tabakut, Kanioni Drinit & Ura e Fshajit etj po japin rezultat sepse sot kemi një numër të vizitorëve që vijnë nga e tërë Kosova.

➤ *Numri vizitorëve në Gjakovë sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK)*

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), rezulton që Komuna e Gjakovës në bazë të kapaciteteve akomoduese për periudhën Janar – Shtator 2019 kishte afërsisht 11,000 vizitorë.

Më poshtë gjeni informata të strukturuar në diagram të ndara sipas përqindjes ku vërehet se numri më i madh i vizitorëve vijnë nga Shqipëria, Gjermania, Zvicra, etj.



Në vitin 2019 zyra e turizmit në kuadër të DZHE-së, ka realizuar një pyetësor i cili iu është shpërndarë njësive akomoduese (9 Hotele dhe 9 Bujtina) në Komunën e Gjakovës në mënyrë që të kemi informata lidhur kapacitetin akomodues të këtyre Hoteleve dhe Bujtinave dhe numrin e turistëve që kanë qëndruar në këto njësi akomoduese gjatë vitit 2019.

Informacionet që janë kërkuar nëpërmjet këtyre pyetësorëve ishin: numri dhomave, numri shtretërve, mesatarja e qëndrimit/natë dhe nga cilat vende ishin kryesisht këta pushues. Sipas këtyre njësive akomoduese, numri më i madh i shtetasve që kane qëndruar janë nga: Shqipëria, Gjermania, SHBA, Zvicër, Turqi, Angli etj.

Paraqitja tabelore e njësive akomoduese për vitin 2019

Njësiti akomoduese	Numri dhomave	Numri shtreterve	Mesatarja netë qëndrimi	Numri për njësi	Totali netë qëndrimi
19	228	546	2.5	5183	18215

Grantet për biznese

Projekti “Fondi për NMVM” ofron një mundësi për komunën për të inkurajuar rritjen e bizneseve Mikro, të Vogla dhe të Mesme.

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK në Komunën e Gjakovës edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar me ndarjen e Granteve për Biznese.

Foto nga disa përfitues të granteve



Me datën 15.05.2019 është bërë publike Thirrja për aplikim, shpallja e konkursit për Grantet për Biznese për vitin 2019 të angazhuara në fushën e prodhimit, përpunimit, zanateve si dhe artizanateve tradicionale.

Qëllimi i Granteve komunale është që të synohet zgjerimi dhe forcimi i kapaciteteve të tyre, të nxitet rritja e punësimit; të sigurohet qëndrueshmëria dhe të jenë aktive në mënyrë që bizneset e tyre të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal të Komunës së Gjakovës.

Vlera e financimit të një Granti ishte nga 2,000 € deri 5,000 €. Vlera mesatare e një granti ka qenë 3,636.00 €, ndërsa vlera e përgjithshme e ndarë nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik për biznese për vitin 2019 ishte 80,000.00 €. Bizneset kanë participuar më së paku 20 % të vlerës së grantit të fituar, varësisht nga kostoja e pajisjes dhe nga vlera e grantit të fituar.

Foto nga disa përfitues të granteve



Me këto Grante është bërë blerja e pajisjes/ve dhe mjeteve të punës për përfituesit e grantit.

Bizneset e udhëhequra nga femrat, nga të rinjtë nën moshën 35 vjeçare dhe bizneset nga komuniteti pakicë, kanë pasur përparësi në pikëzim.


Për arsye të informimit sa më të mirë, me datën 27.05.2019 në ora 10:00 në Sallën e Asamblesë Komunale kemi mbajtur dëgjimin publik me bizneset e interesuara, ku është realizuar prezantimi i skemës së Granteve për këtë vit.

Me vendim të Kryetarit të Komunës z. Ardian Gjini, kemi formuar edhe Komisionin për shqyrtimin dhe Vlerësimin e dokumentacionit i përbërë nga pesë (5) anëtarë, dy prej të cilëve nga shoqëria civile. Ky komision ka bërë përzgjedhjen e projekteve fituese. Në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 89 biznese, dhe nga to 22 biznese janë shpallur fituese nga komisioni për vlerësim të dokumentacionit.



Kemi 5 biznese përfituese të udhëhequra nga femrat dhe 17 biznese përfituese të udhëhequra nga meshkujt, ndërsa në bazë të ndarjes sipas veprimtarive atëherë na del se 17 biznese i kemi në veprimtarinë prodhim/përpunim dhe 5 biznese në zejтари.

Paraqitja grafike e ndarjes së granteve sipas gjinisë në vlerën Euro dhe në %



Grantet janë ndarë sipas Rregullores për ndarjen e Subvencioneve të Maj-it 2015-të.

Buxheti i DZHE-së për vitin 2019:

Përshkrimi:

Paga dhe mëditje	67,338.00 €
Mallra dhe Shërbime	22,000.00 €
Investimet Kapitale	337,000.00 €
Subvencione (Grantet)	80,000.00 €
Totali:	506,338.00 €

Investimet Kapitale

Gjatë vitit 2019 kemi realizuar investime kapitale në disa projekte të cilat janë të lidhura me fushën e turizmit. Këto projekte do të ndikojnë në rritjen e vizitorëve në komunën tonë e cila shprehet në zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Këto projekte janë: Shpella Kusarit, Ura Terzive, Ura Tabakut, Kanioni Drinit & Ura e Fshajit etj të cilat po japin rezultat me numrin e madh të vizitorëve.

Nr.	Emërtimi projektit	Planifikimi
1	Shpellat e Kusarit (rruga, shenjëzimi etj),	35,000.00 €
2	Zhvillimi i pikës turistike në lumin Erenik (faza 2),	60,000.00 €

3	Revitalizimi i Urës së Terezive (ndriçimi, gjelbërimi, shtigjet për ecje)	50,000.00 €
4	Revitalizimi Urës Tabakut (ndriçimi, gjelbërimi, shtigjet për ecje)	15,000.00 €
5	Kanioni Drinit & Ura e Fshajit (ndriçimi i shtegut, urës dhe shtegu për ecje)	70,000.00 €
6	Makineria 4R (riciklo – ripërdor – redukto – rimburso)	22,000.00 €
7	Roler Zip Line	35,000.00 €
8	Ballkoni Panaromik & XXL selfie	20,000.00 €
9	Shtigjet në pemë	30,000.00 €
Total:		337,000.00 €

Gjatë vitit 2019 nga investimet kapitale të planifikuara për këtë vit janë realizuar 6 projekte të cilat si planifikim financiar vlera e tyre ishte 252,000.00 € por kompanitë që kanë fituar tenderët për realizimin e këtyre projekteve kanë ofertuar me **187,555.91 €**.

Projektet e realizuara në bazë të planifikimit dhe të ofertimit të kompanive fituese na del të jetë 73 % të realizimit, ndërsa nëse marrim në total në bazë të investimeve të projekteve që kanë qenë të parapara nga investimet kapitale për vitin 2019 kapin shumen e **55 %**.

➤ Projektet e realizuara në vitin 2019

❖ Shpella e Kusarit (rruga, shenjëzimi etj) – Vlera kontratës 27,241.66 €



Ky projekt është realizuar gjatë vitit 2019. Idea për investimin në këto dy Shpella që janë rreth 10 km nga qyteti i Gjakovës, ishte që të kemi një vend atraktiv për tu vizituar nga qytetarët e komunë sonë e më gjerë. Pas përfundimit të punimeve, kjo bukuri e natyrës është bërë një vend shumë atraktiv për tu vizituar.

❖ **Revitalizimi i Urës së Terzive** (ndriçimi, gjelbërimi, shtigjet për ecje) - Vlera e kontratës rreth **60,000.00 €**



Bashkëfinancim mes DZHE-së dhe Zyrës Bashkimit Evropian (implementuar nga UNDP). DZHE-ja për këtë projekt kishte planifikuar që të investonte **50,000.00 €**. Pas përpilimit të projektit dhe marrjes së vendimit nga ana e Institutit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, që mund tëëinvestojmë në këtë monument, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ndërmjet të UNDP-Kosovë është ofruar që të kemi bashkëfinancim në këtë projekt. Ne si DZHE kemi investuar **27,302.25 €**, ndërsa zyra e BE nëpërmjet te UNDP ka investuar rreth **32,000.00 €** dhe i tërë projekti ka kushtuar rreth **60,000.00**.

❖ **Revitalizimi Urës Tabakut** (ndriçimi, gjëlbrimi, shtigjet) – **Vlera Kontratës 15,000.00 €**



Bashkëfinancim në mes të DZHE-së dhe Zyrës Bashkimit Evropian (implementuar nga UNDP).

DZHE-ja për këtë projekt kishte planifikuar që të investonte **15,000.00 €**, pas përpilimit të projektit dhe marrjes së Vendimit nga ana e Institutit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore që mund të investojmë në këtë monument, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ndërmjet të UNDP-Kosovë është ofruar që të kemi bashkëfinancim në këtë projekt.

Ne si DZHE kemi investuar rreth **10,000.00 €**, ndërsa zyra e BE nëpërmjet të UNDP ka investuar rreth **45,000.00 €** dhe i tërë projekti ka kushtuar rreth **55,000.00 €**

❖ **Kanioni Drinit & Ura e Fshajit** (ndriçimi shtegut, urës dhe shtegu për ecje) – **Vlera Kontratës 65,202.00 €**



DZHE-ja për vitin 2019-të kishte planifikuar për projektin e Kanionit të Drinit & Urës së Fshajit 90,000.00 € ndërsa kompania fituese e ka fituar projektin me 65,202.00 €.

Ideja për realizimin e këtij projekt ishte që të mund të ecim përgjatë gjithë kanionit ku është krijuar shtegu për ecje me rreth 450 metra.

❖ **Zhvillimi pikës turistike në lumin Erenik (faza 2) – Vlera kontratës 36,815.76 €**



Është përfunduar faza e dytë e pikës së lumit Erenik në Guskë. Në këtë fazë kemi investuar në urën e cila është vendosur mbi lumin Erenik. Kjo urë do të lidhë edhe pjesën ku janë disa hektarë toke publike e cila është pastruar dhe mund të shërbejë në të ardhmen për camping apo për rekreacionin e vizitorëve, po ashtu kemi realizuar

❖ **Makineria 4R (riciklo – ripërdor – redukto – rimburso) – Vlera e kontratës 21,750.00 €**

Investimet kapitale të parapara për vitin 2019 e që nuë janë realizuar:

➤ **Roler Zip Line (Planifikimi 35,000.00 €)**

Pas planifikimit për këtë vit, ne si DZHE kemi përpiluar projektin. Ideja e realizimit të këtij projekti ka qenë që të bëhet në Shkugëz, ne si DZHE ta bëjmë investimin dhe pastaj në bazë të konkursit publik këtë investim ta japim në menagjim biznesit fitues, por ky projekt nuk ka arritur të realizohet pasi që Shkugëza është në pronësi të Agjencisë Pyjore të Kosovës, titullari i pronës na ka thënë që ne mund të ju japim pronën tonë me qira për disa vite, por ju si Komunë nuk mund ta ipni me qira palës së tretë.

Këtë projekt e kemi shtyrë për vitin 2020 ku do të shohim mundësinë e gjetjes së një lokacioni tjetër që do ta realizojmë.

➤ **Ballkoni Panaromik & XXL Selfie (planifikimi 20,000.00 €)**

Për shkak të volumit të madh të punëve që kompania projektuese i ka pasur në Komunën e Gjakovës dhe disa problemeve me lokacionin ku do të vendoset ky projekt, përpilimi i projektit është vonuar dhe si pasojë nuk e kemi dërguar fare në prokurim.

Aktivitete tjera të DZHE-së gjatë vitit 2019

➤ Këshilli Publiko – Privat (KPP)

Gjatë vitit 2019-të kemi mbajtur takimet e rregullta me Këshillin Publiko – Privat të bizneseve. Në këto takime, që ishin 4 takime gjatë vitit 2019-të kanë marrur pjesë një numër i konsiderueshëm i bizneseve me të cilat kemi diskutuar për tema të ndryshme në interes të bizneseve të Gjakovës dhe Komunës së Gjakovës.

DZHE dhe Kryetari z. A. Gjini, ka bartur barrën e organizimit të këtyre takimeve.

Foto gjatë takimeve të KLP



➤ **Këshilli Lokal për Punësim (KLP)**

Foto gjatë punimeve të KLP



Pas themelimit të KLP në vitin 2018-të, gjatë vitit 2019-të Komuna e Gjakovës përkatësisht Drejtoria për Zhvillimi Ekonomik, OJQ “Syri i Vizionit”, përfaqësues nga bizneset dhe shkollat profesionale janë takuar dhe kanë përpiluar një draft i “Strategjia dhe plani për punësim 2020 – 2025” për Komunën e Gjakovës.

Qëllimi i kësaj strategjie është ndikimi në orientimin dhe harmonizimin e politikave, programeve dhe shërbimeve mësimore lokale, duke përfshirë praktikën, këshillimin dhe riorientimin në karrierë, për të krijuar një ofertë kualitative, e cila do t’i përmbushë kërkesat në rritje të tregut lokal dhe rajonal për kuadro të kualifikuara.

➤ **Panairi “Gjakova Turistike”**

Zyra e Informacionit Turistik e përfaqësuar nga organizata "ProCult" në bashkëpunim me Komunën e Gjakovës dhe me ndihmën e donatorëve, organizuan eventin "Gjakova Turistike" me rastin e hapjes së sezonit turistik, i cili si qëllim primar kishte promovimin e turizmit. Pjesëmarrës ishin artizan të ndryshëm, përfaqësues të ushqimeve tradicionale, valltarë nga shkollat fillore dhe të mesme, BONEVET me idetë e tyre inovative, grupi "Jakova cycling", Shoqata e bjeshkatarëve "Pashtriku" dhe grupi muzikor "Trio - Don't listen to your neighbors".

Foto nga eventi "Gjakova Turistike"- Qershor 2019 Gjakovë



➤ Panairi Veror "Gjakova 2019"

Komuna e Gjakovës, përkatësisht Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim me organizatën Gjermane HELP dhe ndihmën e Odës Ekonomike të Kosovës-Gjakovë, për herë të parë në shëtitoren e Lumit Krena organizuan Panairin Veror 2019, me ç 'rast u prezantuan artizanatet tradicionale dhe prodhimet vendore nga bizneset e Komunës sonë.

Foto nga Panairi Veror "Gjakova 2019"- Qershor 2019 Gjakovë



➤ Panairi i artizanateve dhe kulinarisë në Gjirokastrë

Me kërkesë nga Zyra e Informacionit Turistik, siç është bërë traditë edhe këtë vit Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka mbështetur pjesëmarrjen e zanatlinjve nga Gjakova në Panairin ndërkombëtar të artizanateve në Gjirokastrë. Qëllimi i pjesëmarrjes ishte përfaqësimi dinjitoz i artizanëve të cilët me produktet e tyre karakteristike promovuan trashëgiminë e pasur kulturore dhe shpirtërore të Gjakovës. Po ashtu përfaqësuesit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik morën pjesë në takimet zyrtare me përfaqësuesit e institucioneve qeveritare, joqeveritare dhe artizanët nga Shqipëria dhe Rajoni duke u bërë kështu pjesë e diskutimeve si dhe duke promovuar vlerat e Komunës së Gjakovës dhe potencialet turistike përmes shpalosjes së materialeve promocionale dhe udhëzuesve turistik në këtë panair.

Foto e përfaqësuesve nga Gjakova në panairin e artizanateve në Gjirokastrë - Shtator 2019



➤ Promovimi përmes Televizionit dhe medieve elektronike

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik pas implementimit të disa projekteve nga fusha e Turizmit si: Shpellat e Kusarit, Ura e Terzive, Ura e Tabakëve, etj, gjatë vitit 2019 ka realizuar një numër të madh të reportazheve televizive, duke promovuar në masë të madhe këto atraksione turistike. Po ashtu edhe me potencialet e tjera karakteristike nga trashëgimia kulturore dhe ajo natyrore me të cilat identifikohet Gjakova, janë realizuar një numër i konsiderueshëm i dokumentarëve dhe reportazheve në televizionet lokale dhe jo vetëm. Duhet përmendur se gjatë vitit 2019 Gjakova ishte kryesisht në fokus të mediave nga Shqipëria, Polonia dhe atyre aziatike.

Foto të shkëputura nga Reportazhet në Klan Shqipëri, Klan Kosova dhe RTSH Shqipëri



➤ Shpalosja e ofertës turistike

Në kuadër të promovimit të Gjakovës si destinacion, Ambasada e Kosovës në Tokyo të Japonisë me ndihmën e ofruar në informacion dhe materiale promovuese nga Zyra Komunale e Turizmit nga DZHE, me datë 18 Qershor 2019 organizoi takim informues, me ç'rast u shpalos oferta turistike e Komunës së Gjakovës para operatorëve turistik nga Japonia.

Foto gjatë prezantimit të ofertës turistike në Ambasadën e Kosovës në Tokyo të Japonisë



➤ Vizitat Kulturore të delegacioneve

Zyra Komunale e Turizmit në bashkëpunim me Zyrën e Informacionit Turistik kanë realizuar disa guida për përfaqësuesit e lartë të cilët kanë qëndruar në Gjakovë për qëllime të ndryshme. Vlen të përmendet përcjellja e grupit të delegacionit të lartë nga Fort Dodge-Iowa me në krye Kryetarin e Komunës Matt Bemrich dhe përcjellësit e tij, pastaj përcjellja e disa grupe të ndryshme të interesit si ambasadorë, reporterë, artistë, poetë, shkrimtarë etj që përformuan në qytetin tonë, ku si shenjë falënderimi ndaj tyre janë realizuar vizitat kulturore duke i njoftuar për së afërmi me potencialet turistike të Gjakovës.

Foto gjatë aktiviteteve



➤ IPA II CBC Programi Shqipëri-Kosovë 2014-2020 “VIA-DINARICA”

Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me organizatën “CDF” nga fondet IPAA të Bashkimit Evropian, implementuan projektin **“VIA DINARICA”** për krijimin e shtigjeve për ecje dhe çiklizëm në Alpet Shqiptare, tashmë pjesë e platformës globale për turizmin malor, e cilësuar nga revista National Geographic Traveler si një ndër vendet më të mira për t’u vizituar. “Via Dinarica” është një shteg 2,000 km i gjatë dhe përshkon Slloveninë, Kroacinë, Bosnjën, Malin e Zi, Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë.

Shqipëria dhe Kosova kanë punuar së bashku edhe gjatë vitit 2019 për një sërë ndërhyrjesh në përmirësimin e infrastrukturës turistike, rigjallërimin e shtigjeve malore në të dy anët e kufirit dhe rritjen e aksesit për të pasionuarit e ecjes në këmbë dhe me biçikleta. Po ashtu gjatë këtij viti janë mbajtur disa trajnime për operatorë turistik, si dhe 2 punëtori për stafin e angazhuar në këtë projekt nga Komuna e Gjakovës.

➤ Projektligji për Turizëm

Foto gjatë takimit për Projektligjin për Turizëm



Me organizim dhe iniciativë të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë – Departamenti i Turizmit gjatë vitit 2019 ka mbajtur disa takime për hartimin e legjislacionit të Turizmit në nivel vendi.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Kategoritë buxhetore komunale

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP, të bazuar në para të gatshme “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”. Shënimet në pasqyrat financiare paraqesin pjesë integrale për ta kuptuar pasqyrën, andaj duhet të lexohen së bashku me pasqyrat.

Pasqyrat financiare janë për Komunën e Gjakovës. Komuna e Gjakovës kontrollohet nga Qeveria e Kosovës dhe të gjitha aktivitetet e tija financohen nga Buxheti i Kosovës.

Komuna e Gjakovës nuk operon me llogarinë e vet bankare. Qeveria operon me funksion të centralizuar të Thesarit i cili e administron pranimin e parave të gatshme të mbledhura nga të

Tabela 1. Trendet historike të financimit sipas strukturës ekonomike për Komunën e Gjakovës 2015-2019, për periudhën JANAR - DHJETOR.

	Komuna e Gjakovës	2015 (Shpenzuar)	2016 (Shpenzuar)	2017 (Shpenzuar)	2018 (Shpenzuar)	2019 (Shpenzuar)
1	Paga dhe mëditje.	11,725,276.29	11,838,180.07	11,713,514.51	13,252,490.92	13,599,827.88
2	Mallra dhe shërbime	1,130,202.23	1,138,464.17	1,233,560.17	2,234,274.89	2,802,467.14
3	Shpenzime komunale	475,051.55	465,292.76	430,052.96	549,083.33	579,693.17
4	Subvencione dhe transfere	432,970.28	449,971.85	397,650.80	459,572.71	482,643.78
5	Shpenzime kapitale	3,496,435.43	5,148,271.09	4,634,189.30	6,613,965.16	8,130,228.64
	Totali :	17,259,935.78	19,040,179.94	18,408,967.74	23,109,387.01	25,594,860.61
	Numri i stafit	2258	2258	2232	2232	2238

gjitha entitetet buxhetore gjatë vitit financiar.

Pagesat e bëra në këtë llogari sa i përket Komunës së Gjakovës janë të paraqitura në kolonën e llogarisë së vetme të Thesarit në Pasqyrën e Pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme.

SHPENZIMET BUXHETORE KOMUNALE




Figure 1. Grafiku i trendit historik të buxhetit Komunal ndër vite dhe pjesëmarrja e kategorive ekonomike buxhetore në buxhet.

Pagat dhe mëditjet

Vlera e mjeteve të parapara për kategorinë buxhetore Paga dhe Mëditje ka shënuar rritje në suaza të normales, shpenzueshmëria në këtë kategori është 99.61%, apo kemi shpenzim në vlerën 13,599,827.88 €.

Mallrat dhe shërbimet

Shpenzimet nga kjo kategori krahasuar ndër vite ka rritje progresive. Rritja e shpenzimeve të realizuara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve gjatë viteve është si rezultat i rritjes së efikasitetit të shpenzimit të parasë publike duke shkurtuar shpenzimet operative që përkojnë me luksin, dhe në të njëjtën kohë duke rrit shpenzimet të cilat ndikojnë pozitivisht në mirëqenien e popullatës së komunës duke rritur cilësinë dhe nivelin e shërbimeve publike. Në këtë kategori shpenzueshmëria është 97.56% apo në vlerën 2,802,467.14 €.

Shpenzimet komunale

Komunalitë apo shpenzimet e ujit, rrymës, telefonisë fikse janë ulur si rezultat i menaxhimit më të mirë të burimeve si dhe si rezultat i kursimeve nga ana e stafit buxhetor. Shënuar në përqindje shpenzueshmëria është 94.46%, apo në vlerë 579,693.17 €.

Subvencionet dhe Transferet

Subvencionet e ofruara nga vitet 2014 - 2016 janë rritur në mënyrë progresive si rezultat i asaj që i është dhënë infuzion zhvillimit entiteteve jo publike si dhe atyre publike. Në vitin 2017 dhe vitin 2018 vlera e subvencioneve ka rënë dukshëm, si rezultati i politikave të Ministrisë të përcaktuara me qarkore dhe duke qenë se ato entitete përfituese të më hershme veqse kanë marr frymën e zhvillimit dhe nuk kanë pasur më shumë nevojë për subvencionim, trend i njejtë ka vazhduar edhe në vitin 2019. Shpenzueshmëria për këtë vit raportues në këtë kategori është 94.09 % apo në vlerë 482,643.78 €.

Shpenzimet kapitale

Mjetet e shpenzuara për Investime kapitale në vitin aktual 2019 në periudhën raportuese janë 8,130,228.64 €, shprehur në përqindje në kontekst të shpenzueshmërisë krahasuar me planifikimin është 91 %.

TË HYRAT BUXHETORE

Në tabelën e bashkangjitur janë të paraqitura të hyrat vetanake komunale sipas Drejtorive Komunale.

N r	BURIMET E TË ARDHURAVE	Realizimi 2014	Realizimi 2015	Realizimi 2016	Realizimi 2017	Realizimi 2018	Realizimi 2019
1	Urbanizmi	188,297.72	296,986.49	490,801.77	312,006.06	638,048.20	505,763.41
2	Shërbimet Publike	34,037.50	9,229.70	13,342.30	30,761.19	76,467.83	36,050.00
3	Inspeksioni	58,554.13	56,977.92	52,272.00	60,574.06	91,980.40	109,649.59
4	Bujqësia	12,246.90	23,044.73	49,899.34	48,141.55	36,241.37	55,649.60
5	Kadastra	143,807.00	165,079.55	137,678.10	166,392.20	165,614.50	153,795.75
6	Zhvillimi Ekonomik	125,880.50	60,358.80	40,507.40	39,757.00	70,211.30	64,943.50
7	Administrata	147,441.00	139,777.50	132,567.50	131,371.00	133,880.57	131,652.05
8	Buxhet e Financa	1,429,847.31	1,344,212.06	1,747,534.10	1,631,239.50	1,645,401.30	1,899,760.18
9	Dënimet në Trafik	213,432.00	141,536.00	195,827.30	268,084.00	516,773.50	555,010.50
10	Të hyrat - gjykata	185,098.88	133,220.00	107,510.00	78,485.00	83,140.00	34,030.00
11	Arsimi	134,839.00	148,511.50	167,366.50	196,165.42	188,192.43	268,584.83
12	Kultura	14,664.50	11,131.00	12,025.00	13,685.00	12,922.50	14,129.00
13	Shëndetësia	43,188.00	51,143.50	57,220.50	54,368.00	62,744.00	88,432.10
TOTALI I TE HYRAVE		2,731,334.44	2,581,208.75	3,204,551.81	3,031,029.98	3,721,617.90	3,917,450.51

14	Donacione /	54,929.62	133,624.77	224,458.04	576,742.06	320,024.71	30,694.18
Gjithsej me Donacione /		2,786,264.06	2,714,833.52	3,429,009.85	3,607,772.04	4,041,642.61	3,948,144.69

Tabela 7. Të hyrat vetanake komunale

Realisht Komuna e Gjakovës për këtë periudhë ka tejkaluar të hyrat e planifikuara në vlerën 450,377.69 apo në normën 12.01 %. Pra kemi suficit në këtë kategori, dhe kjo sigurisht nënkupton më shumë projekte në të mirë të qytetarëve të komunës.

Vlen të sqarojmë se 1,686,809.98 është realizimi i të hyrës më të madhe komunale, tatimit mbi pronën apo shprehur në përqindje 99.63 % me planin vjetor.




Tabela 9. Tabela e të hyrave vetanake sipas Drejtorive Komunale

INFORMACION MBI TATIMIN NË PRONË

Përgjatë kësaj periudhe raportuese konsiderojmë që stafi i angazhuar në sektorin e tatimit në pronë është treguar shumë efikas, këtë duke u mbështetur në të dhënat e sistemit të tatimit në pronë, konkretisht, regjistrimin e pronave të reja dhe verifikimin e atyre ekzistuese si dhe në të hyrat e realizuara deri në fundvit.

ANKETIMI 2017				
PRONA TË REJA	VERIFIKIMI ME FORMULARË	VERIFIKIMI ME LISTË	VERIFIKIMI TOTALI	VERIFIKIMI + TË REJAT
673	888	6061	6,949	7,622
ANKETIMI 2018				
PRONA TË REJA	VERIFIKIMI ME FORMULARË	VERIFIKIMI ME LISTË	VERIFIKIMI TOTALI	VERIFIKIMI + TË REJAT
721	1436	4848	6,284	7,005
ANKETIMI 2019				
PRONA TË REJA	VERIFIKIMI ME FORMULARË	VERIFIKIMI ME LISTË	VERIFIKIMI TOTALI	VERIFIKIMI + TË REJAT
732	664	5199	5863	5863

Ndërkaq tek të hyrat e gjeneruara nga sektori i tatimit në pronë, që njëkohësisht gjeneron edhe të hyrën më të madhe komunale, deri në këtë periudhë raportuese ka grumbulluar 1,686,809.98 € apo 99.63% krahasuar me planin vjetor.

INFORMACION MBI BORXHET

Raporti i obligimeve të papaguara: KOMUNA E GJAKOVËS

Muaji i Raportimit : 31/ 12/2019

Lista e obligimeve

Kodi Organizativ	Emri i Organizatës Buxhetore	Mallra dhe sherbime	Shpenzime Komunale	Subvencionet dhe Transferet	Investimet
632	KOMUNA E GJAKOVËS	421,872.33	28,434.58	57,600.00	234,170.00
	Situacione- Maraveshje				159,789.00
	Eksproprim				55,498.00
	TOTALI				449,457.00

KONKLuzionet:

- Duhet të theksojmë që mbulimi i borxheve është bërë pa ndikuar tek struktura e projekteve kapitale dhe as tek shpenzimet tjera operative, me modesti konsiderojmë që kemi bërë shpenzim racional dhe transparent të parasë publike dhe ulje të shpenzimeve operative në administratës publike.
- Shkalla e shpenzueshmërisë aktualisht është e kënaqshme në të gjitha kategoritë ekonomike, vlen të potencohet se tek kategoria shpenzime kapitale shpenzueshmëria është 91 % në total nga të gjithë fondet financuese.
- Komuna e Gjakovës në vitin 2019 ka realizuar të hyra vetanake mbi 3,948,144.69 € dhe kemi pasur një buxhet suplementar të rritur nga të hyrat vetanake për këtë vit, konkretisht të hyrat vetanake komunale janë tejkaluar për 453,127.69 €.
- Kemi arritur që të respektojmë afatet kohore të parapara me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Qarkoreve Buxhetore 01/02/2019 sa i përket miratimit dhe dorëzimit të Kornizës Afat Mesme Buxhetore për vitet 2020 – 2022 dhe Buxhetit Komunal për vitet 2020 – 2022.
- Gjatë gjithë vitit fiskal 2019 janë certifikuar 8,103 lëndë, janë zotuar 5,650 lëndë dhe janë protokoluar 4,284 lëndë.
- Kemi arritur të bëjmë bartjen e të hyrave vetanake për vitin 2019 në kuadër të kategorive ekonomike duke respektuar Kornizat Ligjore dhe limitet e për caktuara nga Ministria e Financave.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

TË HYRAT DHE SHËRBIMET KADASTRALE TË DREJTORISË PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË - PERIUDHA JANAR-NENTOR 2019

	<i>Fletëposedime</i>	<i>Kopje plani</i>	<i>Certifikata</i>	<i>Historiate(Janar-Nentor</i>	<i>RDPP - Akt.kon. Etj(Janar - Nentor)</i>	<i>Ekip. Gjyq. Janar - Nentor</i>	<i>Hipoteka (Ja-Nentor</i>
Janar - Nentor	-	-	-	46	1470	94	265

<i>REGJISTRIMI I LËNDËVE TË TERRENIT NË "CADASTRE MAP"</i>	
<i>Periudha</i>	<i>Numri i lëndëve</i>
JANAR - NENTOR	702

<i>RAPORTI NGA REGJISTRIMET NË REGJISTRIN E TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME</i>									
<i>PERIUDHA</i>	Numri i transaksioneve të kryera (llojet e regjistrimit)								
JANAR - NENTOR 2019	2324								
<i>PUNËT E KRYERA NË ZYRËN LIGJORE - PERIUDHA JANAR - NENTOR 2019</i>									
<i>Periudha</i>	<i>Numri i lëndëve me karakter Juridik</i>				<i>Të zgjidhura</i>				<i>Të pa zgjidhura</i>
JANAR - NENTOR	1906				1 8 6 7				21
Perqindje(%)	100%				9 8 %				1%

SHPRONËSIMET E REALIZUARA GJATË PERIUDHES JANAR - Nentor 2019														
Qarkorja e Qytetit (Zk. Zidi Sadik Ages I dhe Gjakove Jashte Qytet)									Fazli Haxhi Peqanki					
468,255.00									149,2 87.87 €					
TOTALI(€)														
Mjetet e shfrytëzuara për shpronësim Janar - Nentor 2019									617,5 42.87					
Mjetet te cilat gjenden ne Konto të Mirëbesimit									102,8 06.33					

Drejtoria për Punë Inspektuese

Ky raport pasqyron punën e Drejtorisë për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës për periudhën Janar-Nëntor të vitit 2019. Në këtë raport janë përfshirë punët dhe aktivitetet e kryera nga Drejtoria për Punë Inspektuese (DPI), gjegjësisht nga Sektorit i Ndërtimit në kuadër të së cilit janë Inspektorët e Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, si dhe Sektori për Inspektime në kuadër të së cilit janë Inspektorët e Tregut, Sanitar, Veterinarisë, Bujqësisë dhe Shërbimeve Publike.

Në këtë raport janë paraqitur aktivitetet e kryera gjatë periudhës Janar-Nëntor të vitit 2019, të cilat janë paraqitur sipas fushave që i mbulon secili Inspektorat.

Përmes këtij raporti DPI synon të paraqesë një pamje të qartë të punës së kryer, si kundër problemeve e pengesave që DPI ka hasur gjatë kësaj periudhe.

Të hyrat për periudhën Janar-Dhjetor 2019

Nr.	Përshkrimi	Planifikimi Janar-Dhjetor 2019	Realizimi Janar-Nëntor 2019
1	Të hyrat nga gjobat e Inspektoratit	11,000 Euro	33.460 €
2	Të hyrat nga gjobat e Gjykatës	/	16.050 €
3	Të hyrat nga pëlqimet mbi kushtet higjienoteknike sanitare	32,000 Euro	49.249 €
4	Të hyrat nga taksa për shërbim me pije alkoolike	17,000 Euro	23.680 €
5	TOTALI	60,000 Euro	122.439 Euro

Draft raporti i shkurtër i punëve për periudhën Janar-Dhjetor 2019

Nr.	Përshkrimi	Realizimi Janar-Dhjetor 2019
1	Inspektime	2396
2	Urdhëresa për eliminim të parregullsive	1253
3	Gjoha të shqiptuara	227
4	Lënde të pranuar	843 lënde të pranuar

5	Kallxime penale	1
6	Kërkesa për kundërvajtje	26
7	Kërkesa përmbaremore	56
8	Produkte të asgjësuar	1241 Kg dhe 83 L
9	Aktvendime për ndalim të veprimtarisë	26
10	Certifikata të lëshuara për shërbim me pije alkoolike	130
11	Pëlqime sanitare të lëshuara për ndërtim	24
12	Aktvendime mbi plotësim të kushteve teknike sanitare për lokale afariste	200

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Raporti paraqet të dhëna statistikore për veprimtarinë e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në mënyrë të aktiviteteve të përgjithshme për periudhën Janar-Dhjetor 2019

Sektori i Kulturës 2019

Aktivitete të përgjithshme gjithsej: 161

Shfaqje Teatrale Profesionale e amatore, Ekspozita, Koncerte, Festivale, Orë Letrare, Promovime, Promovime Librash, Debate, WorkShope, etj.

Përfshirë edhe Aktivitetet të cilat janë organizuar në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në kuadër të Agjendës për nder të 17 Shkurtit “Ditës së Pavarësisë”, 14 Qershorit “Ditës së Çlirimit” dhe 28 Nëntorit “Ditës së Flamurit”.

Sektori i Rinisë

Aktivitete të përgjithshme gjithsej: 40

Takime, Prezantime, Promovime, Udhëtime, Pjesëmarrje në Tryeza të ndryshme, etj.

Sektori i Sportit

Aktivitete të përgjithshme gjithsej: 172

Ndeshje Zyrtare, Orë Sportive, Prezantime Sportive, Rekreacion, Trajningje, Ndeshje Tereni, etj.

Subvencionet

Në fushën e Kulturës dhe të Sportit kanë aplikuar 48 OJQ të Kulturës dhe Klube Sportive – 16 OJQ të Kulturës, 32 Klube Sportive. Procesi do të vazhdoj edhe gjatë gjithë vitit për përmbylljen e projekteve për implementim. Në proces të Thirrjes Publike në fushën e Rinisë, ku kanë aplikuar 10 OJQ Rinore – 8 prej tyre janë përfituese nga skema e subvencioneve në përputhje me Thirrjen Publike.

Subvencionet nga Asambleja:

KF “Vëllaznimi” – 40,000.00 euro,

Teatri i Qytetit “Hadi Shehu” – 26,000.00 euro

Ansambl i Muzikës i Komunës së Gjakovës – 4,000.00 euro.

SUBVENCIONET PËR OJQ-të NË FUSHËN E KULTURËS - 2019

1.	OJQ – Neo Muzika / Lyra Fest	2,000.00
2.	OJQ – Qendra e Trajnimit të Valltareve	2,700.00
3.	Komedia Fest	2,000.00
4.	Klubi Letrar “Gjon Nikollë Kazazi” Mitingu i Poezisë	3,200.00
5.	OJQ – Shqiponja Dukagjinit	300.00
6.	OJQ – Emin Duraku – Teatri Amator	1,000.00
7.	OJQ – Ardhmëria	2,000.00
8.	OJQ – Pro Cult	500.00
9.	Ansambli Kulturo Artistik “Isa Boletini”	700.00
10.	Shoqata e Intelektualëve “Jakova”	500.00

SUBVENCIONET PËR OJQ - të rinore në kuadër të sektorit të Rinisë / 2019

1.	OJQ Shoqata e të Shurdhërve	400.00
2.	OJQ Këshilli i Veprimit Rinor Lokal	2.600,00
3.	OJQ “N’ Univers”	1,500.00
4.	OJQ Rrjeti Qeliza	500.00
5.	OJQ IQE	500.00
6.	OJQ EDGE	500.00
7.	OJQ GWYA	2,500.00
8.	OJQ “Du Art”	1,800.00
9.	OJQ SHEPF	500.00

SUBVENCIONET PËR KLUBET DHE OJQ-të SPORTIVE PËR VITIN / 2019

1.	Klubi i Futbollit “Vëllaznimi”	40,000.00
2.	Klubi i Futbollit “Luftëtari”	

3.	Klubi i Futbollit “Dushkaja”	1,000.00
4.	Klubi i Futbollit “Rilindja”	
5.	Klubi i Futbollit “Dukagjini”	1,000.00
6.	Klubi i Futsallit “Liburn”	2,000.00
7.	Klubi i Hendbollit “Vëllaznimi” Meshkujt	7,000.00
8.	Klubi i Hendbollit “Vëllaznimi” Femrat	3,000.00
9.	Klubi i Hendbollit “Shqiponja” Femrat	10,000.00
10.	Klubi i Basketbollit “Vëllaznimi” Meshkujt	6,000.00
11.	Klubi i Basketbollit “Vëllaznimi” Femrat	2,500.00
12.	Klubi i Basketbollit “Vëllaznimi” me karroca	
13.	Klubi i Boksit “Gjakova 137”	800.00
14.	Klubi i Boksit dhe Karatesë “Sport Center”	800.00
15.	Klubi i Karatesë “Jehona”	400.00
16.	Klubi i Çiklistëve “Gjakova 137”	1,400.00
17.	Klubi i Pingpongut “Vëllaznimi”	1,000.00
18.	Klubi i Shahut “Vëllaznimi”	1,200.00
19.	Klubi i Tenisit “Sporek”	400.00
20.	Klubi i Notit “Vëllaznimi”	
21.	Klubi i Volejbollit “Vëllaznimi” Meshkujt	2,000.00
22.	Klubi i Bjeshkatarëve “Pashtriku”	
23.	Klubi i Peshkatarëve “Ereniku”	400.00
24.	Klubi i Peshkatarëve “Radoniqi”	400.00
25.	Klubi i Skijimit “Gjakova”	
26.	Klubi i Skijimit “Pashtriku”	
27.	Klubi i Atletikës “Vëllaznimi”	200.00
28.	Shoqata e personave me aftësi të kufizuara (të verbër)	
29.	Garat e Urës së Fshejtë / Kërcyesit e Urës	2,500.00
30.	Klubi i Automobilave “HCR”	700.00
31.	Klubi i Boksit “EDI”	400.00
32.	Klubi i Futbollit “Dardanët”	1,000.00
33.	Klubi i Futsallit “Letaj”	500.00
34.	Klubi i Volejbollit “Vëllaznimi” Femrat	
35.	Klubi i Tenisit “Hot Shot”	400.00
36.	Klubi i Futbollit “Gjakova”	1,000.00

37.	Klubi i Futbollit “Pashtriku”	800.00
38.	Klubi i Futbollit “Jakova” Femrat	500.00
39.	Klubi i Tenisit “Gjakova”	400.00
40.	Aero Klubi “Gjakova”	500.00
41.	Shoqata e të Shurdhërve	400.00

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Përshkrim i Punëve të Investimeve Kapitale sipas Planit të Prokurimit 2019

Furnizimi dhe Montimi me paisje LED në Palestren e Sporteve “Shani Nushi” Gjakovë

Projekti: Instalimi i paisjeve të ndriçimit (faza e parë), sipas standarteve të FIFA-së dhe UEFA-së,
 Muaji: Nëntor – projekt i kompletuar, Shuma: 10,000.00 euro.

Furnizimi me Rafta në Bibliotekën Publike “Ibrahim Rugova” Gjakovë

Projekti: Montimi i raftave për libra në Bibliotekën Publike, Muaji: Tetor – projekt i kompletuar,
 Shuma: 6,000.00 euro.

Rivitalizimi i Eshtnores – Çabrat në Gjakovë

Projekti: Amfiteater i hapur – rekreativ, Muaji: Kontrat 2 vjeqare – në proces të prokurimit, Shuma e paraparë: 120,000.00 euro.

Renovimi në Muzeun e Familjes Qerkezi në Gjakovë

Projekti: Instalimi i ngrohjes qendrore, Muaji: Dhjetor – projekt i kompletuar, Shuma: 5,000.00 euro.

Renovimi – Rrethimi në fushën e Klubit Futbollistik “Dushkaja” në Gjakovë

Projekti: Rrethimi i fushës së futbollit të klubit “Dushkaja”, Muaji: Nëntor – projekt i kompletuar,
 Shuma: 10,000.00 euro.

Renovimi në shtëpinë e kulturës në fshatin Cërmjan

Projekti: Renovimi i enterierit (situacioni i dytë) në shtëpinë e Kulturës në fshatin Cërmjan, Muaji: Nëntor – projekt i kompletuar, Shuma: 2,848.00 euro.

E zotuar në vlerën 10,000.00 euro me datë 27.05.2019, operatorit i është bërë pagesa në vlerë 7,152.50 euro për situacionin e parë (eksterieri).

Renovimi në Muzeun Etnografik

Projekti: Renovimi i dritareve të objektit, Muaji: Nëntor 2019 / Mars 2020 (dy situacione) – projekt në proces, Shuma: 10,000.00 euro.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

MENAXHIMI I SITUATAVE

Gjatë kësaj periudhe raportuese kjo drejtori me sukses ka menaxhuar pothuajse me të gjitha situatat emergjente në komunë të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore si: me rastin e vërshimeve, zjarreve, rrëshqitjeve të tokës, erërave të forta, tërmetit etj.

Të gjitha këto aktivitete janë ndërmarrë në koordinim me të gjitha institucionet relevante të fushës së mbrojtjes dhe sigurisë në komunë, e në raste më specifike në koordinim edhe me MPB/Agjensionin e Menaxhimit të Emergjencave dhe Ministrinë e Mbrojtjes (FSK-së) dhe Agjensionet tjera përkatëse.

DËMET E SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIT NATYRORE DHE TË TJERA

Përkundër angazhimeve në parandalimin e fatkeqësive natyrore, të gadishmërisë dhe të reagimit emergjent për zbutjen e pasojave të shkaktuara nga këto fatkeqësi, si rrjedhojë e fenomeneve ekstreme natyrore, komuna e Gjakovës në përgjithësi ka pësuar relativisht dëme të vogla materiale dhe fatmirësisht pa pasoja/viktima në njerëz. Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar:

- Viktima në njerëz - zero (0),
- Dëmet materiale nga zjarri:
 - ✓ Dëme nga zjarri në të dy sektorët kanë qenë në vlerë 560,176.00 € (prej të cilave në pronën private 471,531.00 € dhe atë publik 88,645.00 €)
 - ✓ Sipërfaqe të djegura pyjore dhe struktura e tyre:
- Sektori Publik..... 160 hektar, (bungë dhe pishë)
- Sektori privat 210 ha (kryesisht bung) dhe 50 ha tokë pyjore
- Gjithsej: 420 ha sipërfaqe të djegura**

Dëmet e shkaktuara nga tërmeti i nëntorit/2019.....100,500.00 €

NGRITJA E KAPACITETEVE REAGUESE

Përveç përkujdesjes për ngritjen e kapaciteteve për reagim përmes linjës buxhetore të drejtorisë, vëmendje e veçantë i është dhënë “thithjes” së donacioneve si njëra nga mundësitë për avancim teknik në këtë drejtim.

Donacionet e pranuar:

- ✓ Dhurimi nga Ambasada Japoneze në Kosovë e automjetit zjarrfikës me kilometrazhë (0), i tipit Isuzzi në vlerë 67.400 € për nevojat e Shërbimit Zjarrfikës;
- ✓ Mjete dhe paisje të dhuruara nga Shoqata vullnetare e Zjarrfikësve të Baselit (Zvicërr) në vlerë 15.500 CHF, dhe nga
- ✓ KFOR-i Italian në kompletimin e kabinetit të Teknologjisë Informative në NJPZSH.

MASAT PËR PARANDALIMIN E VËRSHIMEVE

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka ndërmarrë veprime konkrete për parandalimin e vërshimeve, të cilat janë vlerësuar si më kritike dhe me potencial vërshimi si:

- ✓ Pastrimi i lumit “Llukac”
- ✓ Pastrimi i lumit “Krena”,
- ✓ Pastrimi i lumit “Erenik”- segmenti në të dy krahët e urës së Tabakut
- ✓ Pastrimi i lumit “Krena” në fshatin Skivjan
- ✓ Pastrimi i përrockës Gusha në fsh Botush,
- ✓ Pastrimi i kanalit të ujit në Brekoc të Ulët (tek varrezat e qytetit) dhe në Dardani
- ✓ Hapje kanali për shkarkimin e ujërave fushor në rr. “Fehmi Agani” dhe e kanalit për parandalimin e ndotjes nga ujërat e zeza në lagjen Dardani rr. “Fitim Domi”;
- ✓ Sanimi emergjent i rrjedhës së ujërave të zeza në fsh Cërmjan, lagja Hoxhaj;
- ✓ Sanimi emergjent i rrugës në lagjen Kokallaj në fsh Cërmjan dhe në rr. “Fitim Domi” në Dradani.
- ✓ Sanimi i urës lokale në fsh. Bardhaniq, lagja Hysenaj
- ✓ Në kuadër të programit të masave preventive për parandalimin e vërshimeve ose zbutjen e pasojave nga to, gjatë këtyre dy viteve janë realizuar gjithsej 33 intervenime në pikat më të ndjeshme të territorit të komunës.





REAGIMI NË ZHBLLOKIMIN E RRUGËVE NGA RRËSHQITJET E TOKËS

Kohëve të fundit, disa segmente rrugore janë duke u ballafaquar me fenomenin e rrëshqitjeve të tokës, që për pasojë shkakton bllokimin e përkohshëm të qarkullimit. Përmes operatorit ekonomik për intervenime emergjente, drejtoria në mënyrë të vazhdueshme ka bërë sanimin e gjendjes në teren.



KOMUNIKIMI EMERGJENT – QENDRA E THIRRJEVE 112



Gjatë vitit 2019 në Qendrën e thirrjeve emergjente janë pranuar dhe evidentuar gjithsej 25860 prej të cilave 571 raste të menaxhuara. Menaxhimi kryesisht është bërë me Zjarrfikësit, Policinë e Kosovës, FSK, KFOR, Kryqin e Kuq, HS Gjakova, KEDS, KRM “Çabrat”, OJQ-të etj.

ZJARRET DHE PREVENTIVA

Shërbimi Zjarrfikës ka intervenuar në gjithsej 1.182 raste, prej të cilave 783 në shuarje të zjarreve dhe 399 intervenime teknike (aksidente komunikacioni, deblokim të dyerëve të blinduara, kërkim-shpëtim në puse, furnizim të banorëve me ujë etj.



Marrë në përgjithësi, situata emergjente në komunën e Gjakovës gjatë vitit të kaluar ka qenë stabile, sidomos kur kemi parasysh trendet e ndryshimeve klimatike në vend, rajon e më gjerë e të cilat zakonisht përcillen me viktime në njerëz dhe dëme të jashtëzakonshme materiale.

